



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 216, dt.14.11.2000

**PER  
MIRATIMIN E SIMBOLEVE TE BASHKISE SE TIRANES**

Me qëllim përfaqësimin sa më real dhe dinjitoz të Bashkisë së Tiranës dhe të qytetarëve që ajo përfaqëson. Pas konsultimeve me specialistë të historisë, heraldikës dhe të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Mbështetur në nenin.113, gërma dh, të Kushtetutës, në ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

**V E N D O S I:**

**I-** Miratohen simbolet e Bashkisë së Tiranës sipas përshkrimit të mëposhtëm

1. Stema e Bashkisë së Tiranës paraqet: Në një shqyt samit të ndarë vertikalisht; në gjysmën e majtë në fushë të kuqe, Kulla e Sahatit e bardhë; në gjysmën e djathtë në fushë blu, ujk i bardhë në profil majtas, me zambak të artë në kthetra (shih fig.1).
2. Flamuri i Bashkisë së Tiranës paraqet: Stemen e Bashkisë së Tiranës, sipas përshkrimit të bërë në pikën 1.a, të vendosur në fushë të kaltër me përmasa 1 me 1,4 (shih fig.2)
3. Stema aktuale e Bashkisë së Tiranës, shfuqizohet dhe hiqet nga përdorimi.

**II** - Ngarkohet Bashkia e Tiranës, me hartimin e Rregullores së përdorimit të Simboleve të Bashkisë.

**III** - Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme me zbatimin e këtij vendimi

**VI** - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**

